



Pranuar / Dorezuar Prenjtenol/Prodato Received/Delivety	31.05.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2752/2021		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.343/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1677/20 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 30.04.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.221/2020 të datës 10/08/2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Qerim Banulla", në Komunën e Lipjanit, kundër Vendimit me Nr. Prot:1387 të datës 20/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa më numër A.nr.221/2020 e datës 10/08/2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 1387 i datës 20/07/2020 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Kontratës për Kohë të pacaktuar si personel Korrektues të datës 30/06/2028 në pozitën "Zyrtar Korrektues" në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, në këtë rast përveç elementeve të marrëdhënies së punës si: kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; dhe zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, mund të ndryshoj me ligj të veçantë elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë,

andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës do të shqyrtoj ankesat vetëm për elementet e marrëdhënies së punës të cilat janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndaj ankuesit më datë 26/06/2020 është nxjerr Vendim me Nr. 1192 me të cilin është larguar përkohësisht nga puna deri në nxjerrjen e vendimit tjetër. Më datë 03/07/2020 Komisioni Hetimor për rastin e ankuesit ka dhënë rekomandim që rasti të trajtohet nga Komisioni Disiplinor.

Më datë 08/07/2020 Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë më datë 08/07/2020 ka iniciuar procedurën disiplinore me arsyetimin se: *"Zyrtari Korrektues Bashkim Gashi supozohet se ka bërë shkelje të Rregullores së Brendshëm të Punës, Kodi i disiplinës pika 9.2, Standarti i Katërt, Marrëdhëniet me të burgosurit, pika g, e cila shprehimisht thotë fut apo nxjerr kontrabandë apo sene të palejuara, si dhe standartet e etikës, pika 11-Mundëso futjen e sendeve që klasifikohen si të ndaluara (kontrabandë) brenda institucionit"*.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 20/07/2020 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 1387 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalimi i 30% të pagës për një periudhë tre mujore"*.

Sipas këshillës juridike të cekur në vendimin e lartcekur, ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot:1387 të datës 20/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10/08/2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1501/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli më datë 31/08/2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsytet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1677/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 11.09.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 10.08.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 10/08/2020 me numër protokolli 1501/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:1387 të datës 20/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Raporti i Oficerit i datës 25/06/2020; Vendim me Nr. 1192 i datës 26.06.2020; E-maili zyrtar i datës 25/26.06.2020; Deklaratë me 25/26.06.2020 nga OF. Deklaratën e datës 25.06.2020 nga ankuesi Inicimi i procedurës disiplinore i datës 08/07/2020; Vendimin i datës 08/07/2020 për formim të Komisionit Disiplinor; Ftesë për Komisionin Disiplinor e datës 08/07/2020; Vendim me Nr.1193 i datës 26.06.2020; Fotografi nga Dhoma A2-07; Deklaratë rreth një rasti në QPPR e datës 25.06.2020 nga Deklaratë nga OF. datës 25/26.06.2020; Deklaratë nga dhe Patent Shofer dhe Kartë Identiteti; Shkresë e intervistës e datës 29/06/2020 nga

datës 30/06/2020; Raporti i hetimit i datës 03/07/2020 nga Komisioni Hetimor; maili zyrtar i datës 25/06/2020; Urdhëresë e datës 27/05/2019; Shkresë për intervistë e datës 10/07/2020 i intervistuar Kontratë pune me kohë të përcaktues e datës 30/06/2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për stafin korrektues i datës 12/12/2018; Vlerësim i rezultateve në punë i datës 10/11/2019; Vendim i datës 25/11/2019 dhe 27/11/2019 për shqiptimin e masës disiplinore për ankuesin dhe Përgjigje në ankesë e datës 31/08/2020; Aktgjykimin A.nr.1677/20 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, pasi ka shqyrtuar shkresën e datës 08.07.2020, me të cilën është iniciuar procedure disiplinore ndaj ankuesit me rekomandim të Komisionit Hetues të datës 03.07.2020 me pretendimet se ankuesi supozohet se ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës, pasi ka shikuar regjistrimet e kamerave ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitareve dhe provat e paraqitura, me datën 20.07.2020, ka nxjerr vendim numër protokolli 1387 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*ndalim i 30% e pagës për një periudhë tre (3) muajore*” me arsyetimin që nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.6 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të parimeve e themelore të Kodit të Etikës dhe urdhëresës së datës 27.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se: Komisioni Disiplinor nuk ka marr për bazë raportin e policisë i cili konstaton se nuk ka elemente të veprës penale dhe se vendimi nuk mbështetet në asnjë provë por jepen formulime të përgjithshme dhe abstrakte, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshme sepse në bazë të shkresave të lëndës, është konstatuar që Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka arritur që në mënyrë bindëse dhe me prova konkrete konkretisht me regjistrimet e kamerave, deklaratat e dëshmitarëve dhe

ankuesit, raportit te komisionit hetues dhe policor të provojnë fajësinë e ankuesit, respektivisht duke marr parasysh veprimet dhe mosveprimet e ankuesit, pakujdesin dhe moskujdesin e ankuesit gjatë kryerjes së detyrës. Ankuesi pretendon se në bazë të Raportit të Oficerit të Policisë së Kosovës të datës 25.06.2020 veprimi i ankuesit nuk është konsideruar që ka elementet e veprës penale, mirëpo kolegji konstaton se kjo nuk do të thotë që nëse ka elemente të shkeljeve të detyrave të punës nuk do të iniciohet procedurë disiplinore, rrjedhimisht sipas këtij raporti thuhet që: *"...Pas shpjegimit të rastit nga na ime Oficeri intervistohet ku thotë se ka futur dy cigare tek i burgosuri..."*, në këtë rast janë shqyrtuar edhe deklaratat e Oficerit i cili deklaroi se *"...Në A/2*

shte caktuar nga Kah ora 19:50 of. 'regoj se të burgosurit që është në vëzhgim tja qoj nja dy cigare i nxorri nga pakoja e vetë..." po ashtu edhe ankuesi në deklaratën e tij të datës 25.06.2020, ka deklaruar që të paraburgosurit ja ka dhënë dy cigare.... Poashtu në bazë të provave të lëndës edhe Komisioni Hetimor ka bërë hetimin e kësaj çështje dhe ka intervistuar dëshmitarët lidhur me këtë dhe në bazë të të gjitha deklaratave është konstatuar që ankuesi ka bërë shkelje të rregullave të marrëdhënies së punës, dhe se ankuesi në intervistën pranë komisionit hetimor, ka pranuar se i ka dhënë dy cigare të burgosurit ku më tutje në intervistë thotë që nuk e ndien vetën fajtor por ka thënë që: *"kërkoj falje nga mbikëqyrësit dhe institucioni për një gabim, lëshim njerëzor, për shkak se i burgosuri është rast psikiatrik, për këtë arsye kam vepru"*, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se vetë ankuesi ka pranuar që ka bërë një veprim të tillë i cili është në kundërshtim me rregullat e brendshme të institucionit.

Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës dhe deklaratimet e lartcekura, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut siç parashihet me nenin 25 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, *zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është në përputhje me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, pasi që ankuesi me veprimet e tij vepruar në kundërshtim me Urdhëresën e datës 27/05/2019 dhe nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 dhe 3.6 të Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: "Shkelje të rënda konsiderohen: moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i i Shërbimit Korrektues të Kosovës në rastin e shqiptimit të masës disiplinore „Ndalim i 30% e pagës për një periudhë tre (3) mujore”, me arsyetimin që nëpunësi ka kryer shkelje disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.6 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të parimeve e themelore të Kodit të Etikës dhe Urdhëresës së datës 27.05.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 50 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se 1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit" dhe 2. "Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer", sepse janë shqyrtuar të gjitha provat dhe faktet duke vlerësuar edhe rrethanat rendues dhe lehtësuese, si dhe rrethanat e tjera pasi që ndaj ankuesit gjatë muajit nëntor 2019 janë shqiptuar edhe dy masa disiplinore, dhe këtë rast masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor është në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se „ Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A nr.343/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.